



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## Thirrje për aplikim

**për licencimin e operatoreve ekonomik për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve për Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik)**

Duke u bazuar në Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve me numër 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022, përmes së cilës përcaktohet mënyra e kryerjes dhe organizimit të transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e Kryeqytetit dhe Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (ku masa P7 e këtij plani parasheh implementimin e “Përmisimit i të Rregullimit dhe Monitorimit të Shërbimeve të Taksive”, drejtoria e Shërbimeve Publike shpall këtë **“Thirrje për aplikim për licencimin e operatoreve Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik)” për organizmin e transportit të udhëtarëve**”

- I. **Taksi Kompani (Person juridik) të cilët aplikojnë për tu pajisur me licenca për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:**
  1. Përshkrim i shkurtër i kompanisë;
  2. Të jetë i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);
  3. Të ketë selinë në territorin e Kryeqytetit;
  4. letër mbështetëse (përkrahje, referencë) nga banka për financimin e blerjes së veturave(e specifikuar me vlerë monetare);
  5. në rast të deklarimit të financimit se do të bëhet me mjete vetanake- të ofrohen dëshmi të verifikueshme mbi gjenden financiare , si p.sh. qarkullimi gjatë dy viteve të fundit, posedim i mjeteve financiare apo marrëveshje/dokument i noterizuar i cili dëshmon këtë financim( duke plotësuar kriteret e lartëshënuara pikën 4 );
  6. të propozoj vendosjen e tri (3) stacioneve për mbushje elektrike të veturave, të cilat do të vendosen: një (1) në hapësirën e vend parkimit të etnitetit juridik dhe dy (2) në hapësira publike që do të përcaktohet nga Kryeqyteti, e cila do të jetë me qasje pa pagesë për të gjithë qytetarët (përfshirë edhe taksistët individual);

**II. Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) të cilët aplikojnë për tu pajisur me licenca për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:**

1. Të jetë i/e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për këtë lloj transporti;
2. të dorëzojë dëshminë se mundet të blej veturë hibride apo elektrike, ose të dëshmon se posedon një të tillë;
3. të jetë banor/e i/e Kryeqytetit (dëshmi për vendbanim);

**III. Vetura me të cilin kryhet transporti taksi i udhëtarëve për Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) duhet:**

1. të jetë me pesë (4+1) ulëse;
2. të ketë timonin në krahun e majtë dhe të ketë së paku katër (4) dyer;
3. të jetë hibrid dhe/apo elektrik;
4. të ketë bazën ngjyrë të bardhë për Taksi Kompani (Person juridik) dhe ngjyrë verdhë për Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik);

Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) të cilët plotësojnë kushtet e lartshënuara do të pajisjen me "Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve", në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve me mundësi vazhdimi.

Afati maksimal për liferimin e veturave, funksionalizimin e flotës do të jetë **1 vit** nga dita e pajisjes me "Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve", në rast të mos përmbushjes së tyre gjatë këtij afati e njëjta do të shfuqizohet.

Të gjitha përgjegjësit dhe obligimet tjera të ushtrimit të veprimtarisë të transportit taksi, rregullohen sipas Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve duke u bazuar në Rregulloren 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022:

<https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2022/12/7.-Vendim-per-miratimin-e-Rregullores-per-auto-taxi.pdf>

Aplikimi së bashku me dokumentet e lartshënuara duhet të dorëzohet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, kati përdhese, Qendra për Shërbim me Qytetar.

Afati për të dorëzuar dokumentet është i hapur prej datës **27.12.2023 deri me datën 27.01.2024 ora 16:00**

**Vërejtje:** Në rast se komisioni gjatë shqyrtimit të aplikacioneve ka nevojë për dokumente apo sqarime shtesë, do t'i kontakton aplikuesit sipas nevojës.